



**RAPORTI VJETOR MBI VEPRIMTARINË
E
KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK,
ADMINISTRIMIT DHE BUXHETIT
PËR VITIN 2020**

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	2
2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINSITRIMIT DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK	2
3. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË SHIFRA	3
4. ARRITJET E KOMISIONIT GJATË VITIT 2020.....	4
5. AKTIVITETI I KOMISIONIT SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË	5
6. PËRMIRËSIMET NË INFRASTRUKTURËN TEKNOLOGJIKE NË FUNKSION TË RRITJES SË TRANSPARENCËS, EFICENCËS DHE AKSESIT NË SISTEMIN GJYQËSOR.....	20
7. PLANIFIKIMI FINANCIAR NË FUNKSIONIN TË ADMINISTRIMIT TË MIRË DHE EFIKAS TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DHE GJYKATAVE	24

1. HYRJJE

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe ë Buxhetit (KPSAB) është një ndër 4 strukturat e përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, i cili u konstitua gjatë mbledhjes planare të datës 18.01.2019. Që në krye të herës që ky komision u krijua, ai ka ushtruar funksione të qënësishme lidhur me planifikimin strategjik, administrimin dhe buxhetit e vetë Këshillit si dhe sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndihmuar kështu Këshillin e Lartë Gjyqësor në përmbushjen me efikasitet dhe cilësi të përgjegjësive dhe detyrimeve ligjore.

Veprimtaria e këtij komisioni, sikurse edhe e tre komisioneve të tjera të përhershme të Këshillit, i nënshtrohet detyrimit ligjor përcaktuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas të cilit parashikohet që: *“Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.”*

Përpos të qenit një detyrim ligjor, hartimi i raportit vjetor të veprimtarisë së këtij komisioni është një proces vetë-vlerësimi dhe vetë-reflektimi mbi sfidat dhe arritjet përgjatë vitit 2020. Vështirësisë së të qenit në fillimet e ushtrimit të funksionit të këtij komisioni, i atashohen edhe problematika të tjera shtesë që mbart procesi i rivlerësimit kalimtar lidhur me vakancat e krijuara në sistemin gjyqësor (veçanërisht për pjesën e nëpunësve civil gjyqësor), tërmeti i nëntorit si dhe pandemia globale e shkaktuar nga Covid -19. Këto fenomene, të cilat sfiduan jo vetëm sistemin gjyqësor por në tërësi shoqërinë shqiptare dhe atë globale, përmos ngarkesës së shtuar, e vendosën Komisionin e Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit në kushte emergjente ku nevoja për të reaguar kërkonte shpejtësi, vizion dhe largpamësi për të adresuar rast pas rasti problematikat e evidentuara.

2. KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË PLANIFIKIMIT STRATEGJIK, ADMINISTRIMIT DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Kompetencat e këtij komisioni burojnë kryesisht nga Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Pikërisht ky kuadër ligjor i ka atribuar KPSAB funksione të rëndësishme në **nivel strategjik**, me qëllim ndjekjen e dinamikave të sistemit dhe marrjen e masave specifike për t’iu përgjigjur në kohë dhe me efikasitet nevojave të tij. Kjo kompetencë e komisionit materializohet me hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik të vetë Këshillit, i cili funksionon si barometër i brendshëm për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit në drejtim të vetë rregullimit dhe mirëqeverisjes së sistemit gjyqësor. Nga ana tjetër, kjo kompetencë lidhet me ndërmarrjen e masave të tjera strategjike, qoftë edhe në nivele *ad hoc*, për adresimin nga pikëpamja strategjike dhe vizionare e çështjeve specifike me të cilat ballafaqohet Këshilli dhe sistemi gjyqësor.

Krahas kompetencave strategjike, ligji i ka atribuar Komisionit funksione të thelluara **administrativo – menaxheriale**. Kompetencë kjo e cila lidhet me rregullimin e brendshëm të gjykatave nga pikëpamja e burimeve njerëzore, infrastrukurore dhe pasurive të paluajtshme/aseteve si dhe përcaktimin e standardeve etike profesionale të nëpunësve civil gjyqësor, me qëllim garantimin e një sistemi funksional dhe eficient. Mirë-administrimi i sistemit gjyqësor ka një fokus të veçantë në veprimtarinë e Komisionit, pasi garanton jo vetëm mbarëvajtjen e sistemit por njëkohësisht përcakton standardet dhe premisat për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të sistemit për t’iu përgjigjur në kohë dinamikave të ndryshme.

Ndër të tjera, KPSAB është përgjegjës për hartimin, miratimin dhe monitorimin e **politikave buxhetore dhe financiare** për Këshillin dhe sistemin gjyqësor, duke garantuar burimet e nevojshme financiare në kuadër të mbarëvajtjes së funksionalitetit të vetë Këshilit dhe gjykatave në vend. Ky kompetencë e Komisionit del në pah sidomos gjatë procesit të planifikimit të projekt-buxhetit afatmesëm (PBA), negociimit e mandjen në monitorimin e zbatimit të këtij buxheti, me qëllim jo vetëm garantimin e standardeve të menaxhimit financiar por mbi të gjitha për vlerësimin e situatës financiare dhe buxhetore në Këshill dhe në sistemin gjyqësor dhe rialokimin apo shpërndarjen e fondeve për përmbushjen e nevojave të identifikuar.


Në ushtrimin e kompetencave të veta, ky Komision ofron një kontribut thelbësor në kuadër të përmbushjes së misionit madhor që Këshilli ka lidhur me qeverisjen, mbarëvajtjen dhe mirë-administrimin e sistemit gjyqësor.

3. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT NË SHIFRA

KPSAB, si struktura përgjegjëse për hartimin, miratimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik, politikave administrative, financiare dhe buxhetore në funksionin të menaxhimit të mirë e efikas të sistemit gjyqësor në vend, gjatë vitit 2020 ka realizuar 84 mbledhje, të cilat janë materializuar në **71** vendimmarrje, nga të cilat:

- **7** janë në fushën e planifikimit strategjik
- **52** janë në fushën e administrimit dhe efikasitetit
- **12** janë në fushën e planifikimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor

Gjithashtu, 12 vendimmarrje të Komisionit i referohen miratimit të procesverbalëve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun. Përmes ndërtimit të faqes së re të internetit të Këshillit, ky detyrim është përmbushur brenda afteve ligjore të arsyeshme duke kontribuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së punës së Këshillit përkundrejt qytetarëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar mbi veprimtarinë e KLGJ-së.



4. ARRITJET E KOMISIONIT GJATË VITIT 2020

Në veprimtarinë e tij 1-vjeçare, Komisioni është udhëhequr nga parime themelore të tilla si profesionalizmi, integriteti, dhe paanshmëria, në funksion të së cilave identifikohen jo pak arritje pozitive. Ndonëse Komisioni, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij është përballur me vështirësi të shtuara si pasojë e fenomeneve natyrore, volumi sasior por edhe cilësor i vendimmarrjeve të tij dëshmon për një angazhim maksimal për të reaguar në kohën dhe me mjetet e duhura ndaj problematikave që kanë sjellë këto fenomene për sistemin gjyqësor në vend. Duke qenë se një pjesë e madhe e vendimmarrjeve, gati 73% e tyre, janë tepër të rëndësishme në kuadër të ndërtimit të një administrate civile gjyqësore profesionale, Komisioni ka bashkëpunuar ngushtë me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Bashkëpunim ky, i cili vjen në funksion të bashkërendimit të angazhimeve për garantimin e ekselencës së sistemit gjyqësorë në të gjitha nivelet.

Disa prej arritjeve më të spikatura të Komisionit¹ janë:

Të rëndësishme!

- ❖ 71 akte të hartuara dhe miratuara.
- ❖ Miratimi i rregullores për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
- ❖ Rritja e eficensës së Gjykatës së Lartë nëpërmjet shtimit të stafit administrativ dhe miratimit të rregullores standarde *“Për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”*²

¹ Komisioni vlerëson se, meqenëse veprimtaria e tij është e ndërvaruar me veprimtarinë e tre Komisioneve të tjera të përhershme të Këshillit, rekomandimet e tij do të parashtrihen në Raportin Vjetor të Këshillit.

- ❖ Reforma për nëpunësin civil gjyqësor e cila merr zanafillën nga miratimi i vendimit “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”.
- ❖ Shpallja e 17 vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit.
- ❖ Emërimi i përkohshëm i 4 këshilltarëve ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe 9 ndihmësve ligjor pranë gjykatave të apelit.
- ❖ Fillimi i verifikimi të kriterëve ligjore, pasurisë dhe integritet për kancelarët në detyrë, ndihmësat dhe këshilltarët ligjor me qëllim garantimin e profesionalizimit, integritetit dhe pastertisë së figurës për këta funksionar publik.
- ❖ Miratimi i propozimit “Për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre” në përputhje me Ligjit nr. 98/2017 “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.
- ❖ Standardizimi i procedurave të plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor, në funksion të garantimit të një administrate sa më profesionale dhe me integritet të lartë në ushtrimin e funksioneve publike përmes miratimit të vendimit “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.
- ❖ Realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor (KLGJ dhe gjykatat) në masën 95%*, duke reaguar në mënyrë të shpejt dhe të drejtë ndaj nevojave të sistemit gjyqësor, në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efektivitet.
- ❖ 4 fishimi i përmirësimeve në sistemin aktual të menaxhimit të çështjeve gjyqësore ICMIS (nëpërmjet 84 zhvillime) passolli rritjen e transparencës, efikasitetit dhe aksesit të qytetarëve në vendimmarrjet e gjykatave.

* Realizimi me 95% i buxhetit për sistemin gjyqësor (KLGJ dhe Gjykata) mund të jetë dhe më i lartë në realitet. Kjo pasi në këtë moment raportohet realizimi i pritshëm për sa kohë që nuk ka përfunduar ende rakordimi (12mujor) me degën e thesarit Tiranë për KLGJ-në dhe me degët e thesarit në rrethe për gjykatat.

5. AKTIVITETI I KOMISIONIT SIPAS FUSHAVE TË VEPRIMTARISË

Bazuar në hulumtimet dhe punën kërkimore, Komisioni ka propozuar, hartuar dhe paraqitur për miratim në Këshill akte, rregullore apo udhëzime të ndryshme të cilat kanë patur në fokus adresimin e problematikave në nivelin strategjik, administrativ dhe financiar të vetë Këshillit si dhe sistemit gjyqësor në Shqipëri.

Vendimmarrjet e KPSAB të realizuara gjatë vitit 2020 në funksion të Planifikimit Strategjik janë si më poshtë vijon:

1. **Vendimi nr. 118, datë 05.03.2020 “Për miratimin e “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.** Ky vendim ka për qëllim

²Vendimmarrje e hartuar në bashkëpunim me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale

miratimin e një prej instrumentave kryesor për garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme dhe transparente nga ana e zyrtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në raport me publikun. Miratimi i kësaj rregulloreje, objekti i të cilës është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësisve dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave ndëshkuese në rastet e konfliktit të interesave, synon të garantoj legjitimitetin e vendimmarrjes së Këshillit si në sytë e aktorëve të sistemit gjyqësor ashtu edhe publikut.

2. **Vendimi nr. 148, datë 05.05.2020 “Për miratimin e “Raport mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2019”.** Komisioni pas vlerësimit të raportit vjetor, i cili përveç pasqyrimit të veprimtarisë së kryer nga KLGJ përgjatë vitit 2019 ofron një përshkrim analitik dhe të detajuar, sipas indikatorëve të performancës, të situatës dhe funksionimit të sistemit gjyqësor bazuar në të dhënat e raportuara nga vetë gjykatat, vendosi miratimin e tij. Ky vendim do të hapte rrugë prezantimit të raportit vjetor në Kuvendin e Shqipërisë pas marrjes së dakordësisë paraprakisht në mbledhjen plenare të Këshillit.
3. **Vendimi nr. 170, datë 28.05.2020 “Për ngritjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”** si dhe **Vendim nr. 171, datë 28.05.2020 “Për përbërjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.** Përmes këtyre vendimmarrjeve, KPSAB sanksionoi jo vetëm krijimin e komisionit të përkohshëm nga pikëpamja formale por mbi të gjitha dakordësoi kompozimin e këtij komisioni me tre anëtarë nga Këshillit (dy prej të cilët anëtarë jo gjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar) si edhe dy anëtarë zëvendësues (një anëtar gjyqtar dhe një jo gjyqtar) të cilët zgjidhen me short.
4. **Vendimi nr. 275, datë 24.08.2020 “Mbi miratimin e listës përfundimtare të gjyqtarëve që do të marrin pjesë në hedhjen e shortit për përzgjedhjen e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor”.** Objekt i këtij vendimi është miratimi i listës prej 16 gjyqtarësh të cilët plotësojnë kushtet për tu përfshirë në short dhe për t'u zgjedhur anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, ndër të cilat edhe kalimi me sukses me vendim të formës së prerë i procesit të rivlerësimit kalimtar.
5. **Vendimi nr. 293, datë 09.09.2020 “Për miratimin e zgjedhjes së tetë anëtarëve të Kolegjit zgjedhor Gjyqësor”,** i cili vjen në vijim të vendimmarrjes së lartpërmedur. Nga hedhja e shortit, KPSAB-ja ka përzgjedhur në mesin e 16 gjyqtarëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor 8 gjyqtarët që do të përbëjnë këtë Kolegj për një mandat 4 vjeçar. Proces i kryer në transparencë të plotë, në seance publike, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të partive politike, organizatave jofitimprurëse me veprimtari në fushën e zgjedhjeve dhe të drejtësisë, dhe medias.

6. **Vendimi nr. 559, datë 12.11.2020 “Për miratimin e listës së gjyqtarëve kandidat për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2021”**, në kuadër të së cilës KPSAB është angazhuar me verifikimin e kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në shortin e përzgjedhjes së anëtarëve të KED. Pas verifikimeve të bëra KPSAB i ka propozuar Këshillit listën e gjyqtarëve, kandidatë që plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pranë Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ndër vendimmarrjet e KPSAB në funksion të mirë-administrimit dhe rritjes së efikasitetit të sistemit gjyqësor, përmendim:

Vendimmarrjet që kanë lidhje me transferimin ose nxjerrjen nga përdorimi të aseteve në pronësi të disa gjykatave për shkak të amortizimit të tyre përfshirë këtu automjete, pajisje zyre, etj të tilla si:

7. **Vendimi nr. 72, datë 20.02.2020 “Për nxjerrjen nga përdorimi të aseteve në pronësi të disa gjykatave”**. Përmes këtij vendimi miratohet nxjerrja nga përdorimi, për shkak të amortizimit, të automjeteve të tipit “Wolswagen Bora” në pronësi të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, automjetin tip “Mercedes Benz” në pronësi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec si dhe aseteve (grup pajisje elektronike) në pronësi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, dhe aseteve (grup pajisje zyre dhe salla gjyqësore) në pronësi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
8. **Vendimi nr. 117, datë 05.03.2020 “Për nxjerrjen nga përdorimi të disa aseteve dhe transferimin kapital të pajisjeve të zyrave”**. Ky vendim ka për qëllim miratimin e nxjerrjes nga përdorimi, për shkak të amortizimit, të aseteve si më poshtë:
- automjetin tip “Alfa Romeo 156” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe automjetin tip “Volksëagen Bora” në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
 - 6 copë motoçikleta të tipit “Loncin” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe motoçikletën e tipit “Peugeot” në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, përmes këtij vendimi, Komisioni hartoi dhe miratoi transferimin kapital të pajisjeve të zyrave të ish-Zyrës së Administrimit Gjyqësor në favor të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. **Vendimi nr.169, datë 28.05.2020 “Për transferimin e disa automjeteve nga Gjykata e Lartë, pranë gjykatave të tjera dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor”**. KPSAB-ja, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës së Gjykatës së Lartë lidhur me amortizimin e automjeteve të tyre për shkak të mospërdorimit për një kohë të gjatë si pasojë e mungesës së gjyqtarëve, i ka propozuar Këshillit miratimi e kalimit kapital, transferimit pa pagesë të tre automjeteve nga Gjykata e Lartë, tek Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës si dhe dy automjeteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

10. **Vendimi nr.263, datë 30.07.2020 “Për transferimin kapital të disa aseteve, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, te zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.** Objekt i vendimit është miratimi i kalimit kapital, transferimit pa pagesë të disa aseteve dhe orendive, (orendi dhe paisje zyrash, tavolina pune, poltrona, karrike, dollape etj), nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tek Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
11. **Vendimi nr. 385, datë 07.10.2020 “Për miratimin e nxjerrjes nga përdorimi dhe transferimin kapital të disa aseteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.** Duke vlerësuar faktin e transferimit fizik/infrastrukturor të veprimtarisë së Këshillit nga godina e ish-KLD-së tek godina “Poli i Drejtësisë”, gjendjen e një pjese të aktiveve disa prej të cilave janë të lidhura ngushtësisht me godinën si dhe faktin tjetër se godina e re është tërësisht e mobiluar me orendi dhe paisje të reja, KPSAB-ja i ka propozuar Këshillit miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve përkatëse si dhe transferimin pa pagesë të një pjese tjetër të tyre tek Departamenti i Administratës Publike, i cili ka marrë tashmë në përgjegjësi administrimin e ish-godinës së KLD-së.
12. **Vendimi nr. 653, datë 29.12.2020 “Për miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të aseteve të disa gjykatave”, bazuar në kërkesat e vetë këtyre të fundit.** Objekti i kësaj vendimmarrjeje të Komisionit është nxjerrja nga përdorimi i aktiveve që plotësojnë kriteret për nxjerrjen nga përdorimi dhe që vlerësohen të panevojshme për aktivitetin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Fier, Durrës, Vlorë, Lushnje, Gjykatës së Lartë, dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në grupin e këtyre aktiveve bëjnë pjesë pajisjet të IT-së, mobilje zyre dhe salle si dhe automjete, të cila janë dëmtuar në atë masë sa riparimi i tyre është pa leverdi ekonomike.

Gjithashtu, vlen të përmendim që ligji i ka ngarkuar Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit një rol të rëndësishëm lidhur me administrimin e sistemit gjyqësor nga pikëpamja e burimeve njerëzore. Kjo kompetencë shtrihet si për administrimin dhe adresimin e problematikave që derivojnë nga procesi i rivlerësimit kalimtar ashtu sikurse edhe në garantimin/ përcaktimin e standardeve apo kriterëve që lidhen me statusin e nëpunësit civil/punonjësit gjyqësor, të tilla si:

13. **Vendimi nr. 115, datë 05.03.2020 “Për detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve shtesë në disa gjykata”,** objekt i të cilës është alokimi në total i 99 punonjësve shtesë për sistemin gjyqësor, nga të cilët 11 janë ndihmësa ligjor, 25 sekretar regjistruar dhe 37 nëpunës gjyqësor.
14. **Vendimi nr. 150 datë 5.05.2020 “Mbi detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve me kontratë në disa gjykata për vitin 2020”.** Ky vendim vjen në kushtet kur Këshilli të Lartë Gjyqësor i miratohen 36 punonjës nga 82 punonjës që ka kërkuar pranë Ministrisë së Financave, në kuadër të projektbuxhetit të vitit 2020. Nisur nga kjo situatë e shkaktuar si pasojë e mosmiratimit të numrit të kërkuar të punonjësve, KPSAB duke marrë në konsideratë edhe numrit përfundimtar të punonjës për vitin 2020 përcaktoi detajimin dhe shpërndarjen e punonjësve për disa gjykata, me qëllim

përmbushjen për sa ishte e mundur të nevojave të tyre për burime njerëzore.

15. **Vendimi nr. 254, datë 09.07.2020 “Për ndërprerjen e mardhënieve në shërbimin civil gjyqësor të kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë znj.Rezarta Taushani, për shkak të dorëheqjes”,** bazuar në shqyrtimit paraprak të kërkesës së znj. Taushani, e cila është shpallur fituese në pozicionin e këshilltarit në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme pranë KLGJ-së.
16. **Vendimi nr. 338, datë 24.09.2020 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”,** vjen si pjesë e setit të akteve nënligjore që Këshilli duhet të nxjerrë në zbatim të ligjit, lidhur me administratën gjyqësore si dhe vlerësimit të rëndësisë së garantimit të statusit të punonjësve gjyqësorë. Objekti i vendimit është përcaktimi me detaje i të gjithë procedurës dhe kritereve për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor punonjësve të cilët aktualisht ushtrojnë funksionet e tyre nëpër të gjitha gjykatat e vendit, duke garantuar kështu transparencë dhe meritokraci në administratën civile gjyqësore. Ky vendim ka bërë të mundur që Këshillat e Gjykatave të rinisin menjëherë shqyrtimin e dosjeve personale të të gjithë punonjësve me qëllim paisjen e tyre me statusin e nëpunësit civil gjyqësor. Vlen të përmendet se kjo vendimmarrje është një ndër aktet më të rëndësishme të Këshillit, në zbatim të së cilit fillon, për herë të parë, një proces transformimi 360 gradë i administratës civile gjyqësore. Ky është një proces i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me thelbin e vetë reformës në drejtësisë si një instrument kyç për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore ndaj qytetarëve. Përmes përcaktimit të kritereve objektive, të paanshme, profesionale dhe rigoroze si dhe standardizimit të procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor synohet garantimi i integritetit, përgjegjshmërisë, meritokracisë dhe profesionalizmit të administratës civile gjyqësore. Rëndësia e këtij procesi, sikurse është përcaktuar në ligj por edhe në dokumentet strategjik të Këshillit, konsiston në përmirësimin e vazhdueshëm të administratës civile gjyqësore duke përcaktuar vendosjen e standardeve të qëndrueshme në funksion të cilësisë, organizimit eficient të strukturave, rritjes së përgjegjshmërisë së punonjësve, transparencës në ushtrimin e funksioneve dhe përmirësimit të shërbimeve ndaj publikut. Nisja e këtij procesi dhe vazhdimi i tij mbështetet në parimet e rëndësishme të profesionalizimit dhe meritokracisë me qëllim ndërtimin e një administrate të qëndrueshme dhe të aftë për të përballuar sfidat që po kalon sistemi gjyqësor.
17. **Vendimi nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”,** i cili përcakton rregulla të hollësishme për procedurën e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor. Ky propozim i KPSAB-as synon të standardizojë në mënyrë tërësisht transparente dhe profesionale procedurat e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor, në funksion të garantimit të një administrate sa më profesionale dhe me integritet të lartë në ushtrimin e funksioneve publike.

18. **Vendimi nr. 643, datë 23.12.2020 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të kategorive të punonjësve të Gjykatës së Lartë”,** i cili bën të mundur plotësimin e bazës ligjore për organizimin dhe funksionimin e strukturës së brendshme të Gjykatës së Lartë, me qëllim funksionimin sa më efektiv, profesional dhe transparent të veprimtarisë së kësaj gjykate. Kjo vendimmarrje vjen në vazhdim edhe të angazhimit të ndërmarr në kuadër të hartimit dhe miratimit të “Udhërrëfyesit për Funksionalitetin e Gjykatës së Lartë”, një instrument me rëndësi jetike si në lidhje me plotësimin e numrit të gjyqtarëve ashtu edhe në kuadër të arritjes së kushteve optimale infrastrukturore dhe njerëzore, metodave të punës dhe sistemeve të menaxhimit të të dhënave për një Gjykatë të Lartë jo vetëm funksionale por edhe efeciente. Përmes këtij akti, KPSAB-ja synon transformimin e Gjykatës së Lartë në një gjykatë karriere ku përcaktimi i standardeve të mirëorganizimit dhe funksionimit të saj merr një vlerë të shtuar.
19. **Vendimi nr. 492, datë 21.10.2020 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z.Gentian Lile, për shkak të dorëheqjes”.** Duke vlerësuar si të drejtë dhe të mbështetur në ligj kërkesën për dorëheqje të ndihmësit ligjor z.Gentian Lile pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Gjirokastër, pas shqyrtimit paraprak të saj, KPSAB-ja i ka propozuar Këshillit miratimin e kërkesës për dorëheqje. Kërkesa për dorëheqje është motivuar për arsye familjare dhe objekt i saj është ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, z. Gentian Lile, për shkak të dorëheqjes.
20. **Vendimi nr. 493, datë 21.10.2020 “Për caktimin e strukturës së posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.** Duke vlerësuar rëndësinë që ka ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe për shkak të miratimit të strukturës organizative të Këshillit, me qëllim përshtatjen e detyrave konkrete me funksionet përkatëse, KPSAB-ja i ka propozuar Këshillit caktimin e strukturës e cila ka si detyrë regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit. Në kushtet e reja të krijuara pas funksionimit të Këshillit dhe shkrirjes së ish-KLD-së, miratimin e strukturës së re të organizimit, me qëllimin vijimin e punës në përputhje me kompetencat dhe funksionet, Këshilli ka miratuar propozimin e ardhur nga KPSAB-ja me objekt caktimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, si strukturë e posaçme, për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit si dhe shfuqizimin e vendimit nr.39, datë 11.4.2016 dhe vendimit nr.54, datë 25.4.2016, të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
21. **Vendimi nr. 496, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”.** Me qëllim pasjen jo vetëm të trupës gjyqësore profesionale

dhe me integritet por dhe personelit ndihmës dhe mbështetës gjyqësor, KPSAB-ja, në zbatim të dispozitave ligjore i ka propozuar Këshillit fillimin e procedurës për verifikimin e kancelarëve në detyrë. Objekt i vendimit është fillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale, të pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë si dhe caktimi me short i relatorit për secilin kancelar.

22. **Vendimi nr. 497, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor”.** Në funksion të garantimit të një trupe profesioniste dhe me integritet ndihmësish dhe këshilltarësh ligjor me qëllim mbështetjen e punës së gjyqtarëve në gjykatat e apelit të vendit dhe Gjykatën e Lartë, KPSAB-ja, në zbatim të dispozitave ligjore i ka propozuar Këshillit fillimin e procedurës për verifikimin e kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor që kanë përfunduar me sukses formimin fillestar pranë shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020 si dhe caktimi i relatorit për secilin kandidat.
23. **Vendimi nr. 498, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për këshilltarë dhe ndihmës ligjor, në vitin akademik 2020-2021”.** Objekt i vendimit është fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për praninë në shërbimin civil gjyqësor që kanë përfunduar me sukses formimin fillestar pranë shkollës së Magjistraturës, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor, për vitin akademik 2020-2021 si dhe caktimi i relatorit për secilin kandidat.
24. **Vendimi nr. 552, datë 12.11.2020 “Për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, të shpallur me vendimin nr. 498 , datë 21.10.2020, për kandidatin për ndihmës ligjor z. Ilir Korbi”.** KPSAB-ja duke vlerësuar si një të drejtë ligjore kërkesën për tërheqje nga kandidimi për ndihmës ligjor të z. Ilir Korbi, i ka propozuar Këshillit përfundimin e procedurës së verifikimit për këtë kandidat.

Për shkak të situatës së krijuar në **Gjykatën e Lartë** si pasojë e mos funksionimit për një periudhë 2 vjeçare dhe një stoku çështjesh të prapambetura gjithmonë e në rritje, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, KPSAB-ja me qëllim dhënien e ndihmës dhe lehtësimin e punës në këtë gjykatë ka miratuar një sër vendimmarjesh si më poshtë:

25. **Vendimin nr. 554, datë 12.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të z. Metush Meçka në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë”.**
26. **Vendimin nr. 555, datë 12.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Edlira Llango në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë”.**
27. **Vendimin nr. 556, datë 12.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të z. Gerti Shani në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë”.**

28. **Vendimin nr. 557, datë 12.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Evriklejda Semani në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë”.**
29. **Vendimin nr. 642, datë 23.12.2020 “Për shqyrtimin e kërkesës për pasje/njohje të statusit të këshilltarit/ ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë të z. Alfred Balla”, në kuadër të së cilit Komisioni i ka propozuar Këshillit të pezullojë shqyrtimin e kësaj kërkesë për sa kohë që ajo është ende për shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

Përpos Gjykatës së Lartë, një vëmendje të veçantë Komisioni i ka kushtuar edhe administrimit të situatës në **gjykatat e apelit**, për shkak të vakancave të krijuara si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar. Ndaj për të adresuar këtë situatë, KPSAB ka miratuar sa më poshtë vijon:

30. **Vendimin nr. 553, datë 12.11.2020 “Për detajimin e pozicioneve aktuale të ndihmësave ligjorë nga gjykatat administrative të shkallës së parë pranë gjykatave te apelit”.**
31. **Vendimin nr. 577, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të z. Aurel Celibashi, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.**
32. **Vendimin nr. 578, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Aneta Strakosha, në pozicionin e ndihmësës ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.**
33. **Vendimin nr. 579, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Enida Lamçe, në pozicionin e ndihmësës ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.**
34. **Vendimin nr. 580, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Majlinda Tosku, në pozicionin e ndihmësës ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.**
35. **Vendimin nr. 581, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Laureta Ahmeti, në pozicionin e ndihmësës ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.**
36. **Vendimin nr. 582, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të z. Roland Agolli, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Durrës”.**
37. **Vendimin nr. 583, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Ornela Troplini, në pozicionin e ndihmësës ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Durrës”.**

38. **Vendimin nr. 584, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të z.Ervin Xhiani, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Korçë”.**
39. **Vendimin nr. 585, datë 20.11.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj.Albana Palaj, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor Pranë Gjykatës së Apelit Shkodër”.**
40. **Vendimin nr. 586, datë 20.11.2020 “Për shpalljen e vendeve vakante për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”.**
Në funksion të administrimit dhe menaxhimit të strukturave gjyqësore, KPSAB-ja i ka propozuar Këshillit shpalljen e 17 vendeve në pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit (Tiranë - 6 ndihmës ligjorë, Durrës - 1 ndihmës ligjorë, Gjirokastrë - 2 ndihmës ligjorë, Korçë - 1 ndihmës ligjorë, Shkodër - 1 ndihmës ligjorë, Vlorë - 3 ndihmës ligjorë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 3 ndihmës ligjorë)
41. **Vendimin nr. 611, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Esida Bruçi, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”**
42. **Vendimin nr. 612, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Irena Zhurka, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës”**
43. **Vendimin nr. 613, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Gersiana Skifteri, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”**
44. **Vendimin nr. 614, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Enkelejda Patrioti, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”**
45. **Vendimin nr. 615, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj.Nertila Kalanxhi, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”**
46. **Vendimin nr. 616, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të z.Sokol Loci, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”**
47. **Vendimin nr. 617, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Blerta Hamzallari, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”**

48. **Vendimin nr. 618, datë 10.12.2020 “Për emërimin e përkohshëm të znj. Eglantina Shabanaj, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”**

Muaji mars i vitit 2020 do të shënonte fillimin e pandemisë globale të shkaktuar si pasojë e përhapjes së infeksionit Covid-19, në kuadër të së cilës e gjithë veprimtaria politike, sociale dhe ekonomike e vendit u pezullua. Në përputhje me Aktin Normativ Nr. 9 datë 25.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”. Komisioni i ka propozuar Këshillit vendimmarrjet e mëposhtme:

49. **Vendimin nr. 127, datë 10.03.2020 “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”**
50. **Vendimin nr. 128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë së shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë”**
51. **Vendimin nr. 133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë së shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë”**

Komisioni ka vendosur përjashtimin nga efektet e këtij pezullimi veprimtarinë dhe shërbimet gjyqësore që lidhen me çështje me natyrë të ngutshme, të vlerësuara si të tilla rast pas rasti nga gjyqtari (si p.sh. seancat gjyqësore që kanë lidhje me masat e sigurimit, afatet e paraburgimit, etj) si dhe në çdo rast, ndalohet prania e publikut në mjediset e gjykatave. Gjatë periudhës së pezullimit, KPSAB-ja vendosi që komunikimi i publikut me gjykatat mund të realizohet vetëm nëpërmjet postës zyrtare, postës elektronike (email), ose online, nëpërmjet faqeve zyrtare të internetit të gjykatave.

52. **Vendimin nr. 143, datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”,** i cili vjen në në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Covid-19. Ky propozim bazohet në Udhëzuesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Rekomandime të përgjithshme ndaj subjekteve të biznesit që lejohen të zhvillojnë aktivitetin në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së Covid-19” si dhe rregullores së Këshillit lidhur me “marrjen e masave kufizues për përhapjen e Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së KLGJ”.
53. **Vendimin nr. 251, datë 09.07.2020 “Për rishpërndarjen e fondeve për masat higjienizuese në gjykata”.** Propozimi nga KPSAB-ja për miratimin e këtij vendimi, ka ardhur si një vlerësim i rëndësishëm që ka bërë Këshilli lidhur me masat që duheshin marrë, në kuadër të masave të përgjithshme të ndërmarra nga të gjitha institucionet shtetërore, për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata. Vendimi ka për objekt të tij rishpërndarjen e fondeve buxhetore të gjykatave të vendit duke u dhënë mundësinë atyre marrjen e

masave të menjëherëshme për blerjen e paisjeve, dizinfektimin e të gjitha ambienteve, në funksion të parandalimit të përhapjes së Covid 19.

Në kuadër të administrimit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor, por njëkohësisht edhe ndërmarrjes së masave/politikave strategjike të bazuara në evidenca dhe të dhëna statistikore, Komisioni gjatë ushtrimit të funksioneve të tij është përqëndruar në mënyrë të vecantë, ndër të tjera, edhe në administrimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS). Ndër vendimmarrjet që kanë në fokus këtë sistem, vlen të përmenden sa më poshtë vijon:

54. Vendimi nr. 114 datë 05.03.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”. Përmes këtij vendimi KPSAB, përcaktoi dhe miratoi përbërjen e grupit të punës i cili do të mundësojë funksionalitetin e sistemit ICMIS pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky grup pune ngarkohet me përgjegjësinë për të garantuar nga pikëpamja teknike ruajtjen e informacionit gjatë periudhës së tranzicionit nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda në Gjykata të Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe mundësinë e përdorimit të këtyre të dhënave në funksion të përpunimit të informacionit dhe prodhimit të raporteve statistikore për aq as është e mundur teknikisht nga sistemi.

Përpos sa më sipër, vendimmarrje të tjera të Komisionit lidhur me administrimin e sistemit gjyqësor janë:

55. Vendimi nr. 641, datë 23.12.2020 “Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre, mbështetet sa në praktikën aktuale të gjykatave vendase aq edhe në eksperiencën e vendeve të rajonit sikurse dhe standardet ndërkombëtare (CEPEJ). Në kuadër të këtij vendimi, është kryer një studim mbi tarifave gjyqësore, bazuar kryesisht në të dhënat e mbledhura nga gjykatat e vendit. Ky studim, i cili ka gjetur mbështetjen e plotë të partnerëve ndërkombëtar, dhe ka shërbyer si një bazë mbi të cilën është projektuar propozimi aktual i tarifave gjyqësore. Qëllimi i këtij propozimi është jo vetëm reflektimi i standardeve ligjore, por mbi të gjitha garantimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore duke mos cënuar në asnjë moment aksesin e qytetarëve në drejtësi. Në hartimin dhe miratimin e këtij propozimi, është mbajtur parasysh progresiviteti dhe proporcionaliteti i tarifave gjyqësore në shkallë të ndryshme të gjykimit, garantimi i cilësisë së shërbimeve gjyqësore dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në drejtësi. Propozimi mbi tarifave gjyqësore i është nënshtruar një procesi të hapur, pro aktiv dhe gjithë përfshirës konsultimi me grupet e interesit, përfshirë 38 gjykatat e vendit, 15 organizatat jo fitimprurëse si dhe Ministrinë e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës së bashku me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për miratimin me udhëzim të përbashkët të tarifave gjyqësore. Gjithashtu, ky propozim i KPSAB-së është hartuar në bashkëpunim me projektet që mbështesin Këshillin, përkatësisht EURALIUS V dhe Drejtësi Për Të Gjithë (Justice for All) USAID, të cilët kanë patur një kontribut të rëndësishëm në përafrimin e modeleve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

56. **Vendimi nr. 116 datë 05.03.2020 “Për rialokimin e fondeve për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë së godinave të gjykatave”.** Komisioni si njësi përgjegjëse brenda Këshillit për administrimin e gjykatave të vendit, vendosi rialokimin e fondeve në funksion të ruajtjes dhe sigurisë së godinave të gjykatave. Ky fond nuk u detajua për çdo gjykatë, por u la i pashpërndarë, deri në saktësimin e nevojës për çdo gjykatë, referuar kontratave ekzistuese individuale të gjykatave dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 04.04.2019 “Për krijimin e shoqërisë Ilyrian Guard sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie”.
57. **Vendimi nr. 119 datë 05.03.2020 “Për miratimin e Raportit vjetor të auditimit të pushtetit gjyqësor për vitin 2019”.** Përmes këtij akti, Komisioni ushtron funksionin e kontrollit të brendshëm me qëllim vetëvlerësimin e efikasitetit të drejtimit të financave publike në sistemin gjyqësor. Ky raport i miratuar bazohet në veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, i cili ka realizuar mesatarisht 12 auditime të plota nga 13 të planifikuara. Në Raportet Final të Auditimit, që u janë dërguar Gjykatave janë dhënë rekomandimet përkatëse të detyruara e pranuar për zbatim nga çdo gjykatë brenda afateve të përcaktuara.

Në funksion të mirëfunksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe buxhetor, KPSAB ka ndërmarrë vendimmarrjet e mëposhtme:

58. **Vendimi nr. 71, datë 20.02.2020 “Për detajimin e buxhetit në shpenzime kapitale për sistemin gjyqësor, për vitin 2020”,** i cili miratoi:
- Buxhetin për programin 01110 “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, në shumën 49,600 mijë. Me këtë buxhet të investimeve për vitin 2020, plotësohen nevojat kryesisht për: paisje kompjuterike dhe paisje të tjera elektronike të evidentuara nga specialistët e IT, sistemi audio video për sallën e mbledhjeve plenare të KLGJ-së, dhe sistemi i qarkullimit të dokumenteve.
 - Buxhetin për programin 03310, “Buxheti gjyqësor” në shumën 158,400 mijë lekë, i cili mori në konsideratë disa prioritete që lidhen me: ruajtjen e standarteve në fushën e infrastrukturës elektronike, plotësimin e disa kërkesave të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, nevojat për rikonstruksion të gjykatave të dëmtuara nga tërmeti i nëntorit, si edhe nevojat e reja të paraqitura nga gjykatat.
59. **Vendimi nr. 138, datë 16.04.2020 “Mbi miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”.** Në kushtet kur disa disa veprimtari të Këshillit ashtu sikurse edhe të gjykatave në të gjithë vendin, u pezulluan përkohësisht për shkak të pandemisë globale Covid-19, Komisioni konkludoi në miratimin e fondeve të lira nga buxheti i vitit ushtrimor 2020:
- Në shumën prej 23 milion nga programi 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” që i referohet buxhetit të KLGJ-së.
 - Në shumën prej 52,984 mijë nga programi 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i

Gjykatave.

Këto fonde rezultojn të ishin pakësime kryesisht nga zëri i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore personeli si dhe zëri i investimeve nga buxheti i KLGJ-së. Përmes këtij vendimi, KPSAB-ja kishte si qëllim që këto fonde të lira ti viheshin në dispozicion/t'i propozoheshin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të rishikimit të Buxhetit të Shtetit me qëllim përbalimin financiar të situatës së krijuar nga Covid-19.

60. **Vendimi nr. 149, datë 05.05.2020 “Mbi miratimin e detajimit të fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor, sipas aktit normativ nr.15/2020”.** KPSAB-ja, pas detajimit të numrit shtesë të punonjësve të sistemit gjyqësor të miratuar me ligjin nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020, ku për pasojë është rritur edhe numri faktik i personelit gjyqësor në gjykatat e vendit, i ka propozuar Këshillit detajimin e fondeve shtesë, duke vlerësuar të domosdoshëm rishikimin e buxhetit në shpenzime personeli. Objekt i vendimit është miratimi i detajimit të fondeve shtesë sipas nevojave të gjykatave, në shpenzimet personeli, përkatësisht për shpenzime paga dhe sigurimesh shoqërore.
61. **Vendimi nr. 168, datë 28.05.2020 “Për miratimin e detajimit të fondeve shtesë në shpenzime personeli, në Programin Buxheti i Gjykatave”.** Objekti i këtij vendimi është miratimi i detajimit të fondeve shtesë sipas nevojave të gjykatave, në shpenzimet personeli në shumën prej 73,820 mijë lekë, nga të cilat: shpenzime pagash në shumën 61,470 mijë lekë dhe shpenzime sigurimesh shoqërore në shumën 12,350 mijë lekë. Detajimi i këtij fondi shtesë vjen pas rishikimit të buxhetit në shpenzime personeli, për buxhetin e gjykatave, ndikuar nga miratimi i Vendimit i Këshillit nr. 115, datë 5.3.2020, që passolli si pasojë rritjen e organikës së gjykatave. Fondet e mbetura të pa detajuara, në shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore), në shumën prej 121,930 mijë lekë, mbeten të tilla, deri në momentin e shfaqjes së nevojave nga emërimet të reja në sistemin gjyqësor.
62. **Vendimi nr. 252, datë 09.07.2020 “Mbi shpërndarjen e fondeve në investime”,** ka si objekt të tij shpërndarjen e fondeve buxhetore për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në godinat e: Gjykatës së Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Krugë, Tiranë, Lezhë dhe Kurbin. Kjo shpërndarje e fondeve është bazuar në analizën e thelluar të informacioneve të siguruar nga vetë gjykatat lidhur me dëmet materiale që kishin pësuar nga ky fenomen natyror.
63. **Vendimi nr. 253, datë 09.07.2020 “Për rishikimin e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin 2020, sipas aktit normativ nr.28, datë 02.7.2020”,** pati si rezultat pakësimin e buxhetit gjyqësor, kryesisht për shpenzime personeli, të ndara në fonde për paga dhe sigurime shoqërore, për të gjitha gjykatat, përfshirë edhe Gjykatën e Lartë. Ky rishikim i buxhetit të sistemit gjyqësor u realizuar si pasojë e gjendjes së fatkeqësisë natyrore shkaktuar nga tërmeti dhe pandemia globale Covid-19.

64. **Vendimi nr. 270, datë 24.08.2020 “Për miratimin e kërkesave buxhetore, PBA 2020-2022 (Faza e Dytë) të sistemit gjyqësor”.** Në funksion të administrimit dhe menaxhimit me përgjegjësi të buxhetit gjyqësor, KPSAB-ja ka shqyrtuar paraprakisht kërkesat buxhetore dhe projekt-buxhetin afatmesëm 2020-2022. Në hartimin e këtij akti, të propozuar në Këshill, KPSAB-ja ka argumentuar se kërkesat buxhetore, janë përgatitur duke patur parasysh historikun e shpenzimeve të programeve. Më konkretisht, realizimi i vitit 2019 dhe buxheti i miratuar për vitin 2020 si dhe struktura buxhetore e ndarë në dy programe, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ato për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të gjitha nivelet.
65. **Vendimi nr. 321, datë 17.09.2020 “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime personeli, të programit 3310 “Buxheti gjyqësor”.** Propozimi i këtij vendimi ka ardhur nga KPSAB-ja, pas shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe asaj të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të cilat kanë kërkuar miratimin e dhënies së shtesës së pagës për vështirësi në punë për funksionin e gjyqtarit në përputhje me parashikimet e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Duke vlerësuar të drejtë kërkesën dhe në përputhje me dispozitat ligjore, pas analizës së fondeve buxhetore në dispozicion, KPSAB-ja, ka propozuar rishpërndarjen e fondeve buxhetore për paga, duke pakësuar fondin e pagave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjirokastrë dhe duke shtuar fondin në paga për gjykatat e posaçme, me objekt përfitimin e shtesës mbi pagë sipas ligjit të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme.
66. **Vendimi nr. 386, datë 07.10.2020 “Për rishpërndarjen e fondeve në shpenzime kapitale (investime), në programin buxhetor “Buxheti i gjykatave”.** KPSAB-ja pas vlerësimit dhe rëndësisë së dhënë në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuara nga Strategjia e Drejtësisë për të Mitur, (Plani i veprimtimit 2018 –2021), pas analizimit të ambienteve të gjykatave të vendit për të filluar realizimin e përshtatjes në ambiente miqësore për të miturit, ka propozuar katër gjykata për të adaptuar këtë projekt. Gjykatat e vlerësuara nga KPSAB-ja të cilat kanë ambiente të mundshme për të realizuar dhoma apo salla miqësore për të miturit janë Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Elbasan dhe Dibër. Gjithashtu KPSAB-ja, në vlerësim të sigurisë së ambienteve të të gjitha gjykatave dhe pas shqyrtimit të kërkesës së Gjykatës së Lartë ka propozuar rialokim fondesh për vendosjen e sistemit të sigurisë. Objekt i vendimit është rishpërndarja e fondeve, në investime, në buxhetin e gjykatave, për Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit Shkodër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
67. **Vendimi nr. 558, datë 12.11.2020 “Për miratimin e shpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime operative, të programit 03310 “Buxheti Gjyqësor”.** Për shkak të vakancave të krijuara në sistemin gjyqësor si pasojë e procesit të rivlerësimit

kalimtar dhe situatës të krijuar nga Covid-19 për të cilën gjykatat kanë bërë shpenzime të paparashikuara për dezinfektimin e ambienteve të tyre, KSPAB vlerësoi se rishpërndarja e fondeve do të bënte të mundur shfrytëzimin efikas të fondeve të papërdorura dhe shlyerjen e detyrimeve brenda këtij viti, pa kaluar në detyrime të prapambetura për vitin 2021. Në kuadër të mirëadministrimit dhe menaxhimit të fondeve të buxhetit gjyqësor, KPSAB dakordësoi dhe i parashtrori Këshillit rishpërndarjen e fondeve buxhetore në shpenzime operative, për disa gjykata të vendit.

68. Vendimi nr. 593, datë 26.11.2020 “Për miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit 2020, në sistemin gjyqësor”. Bazuar në kërkesën e ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për konfirmim fondesh të lira me qëllim pakësim në buxhetin 2020, KPSAB ka përpunuar informacionin mbi të dhënat buxhetore të përdorura në sistemin gjyqësor me qëllim evidentimin e fondeve të lira. Nëpërmjet një analize të detajuar të zërave buxhetorë për vitin 2020, të të dy programeve buxhetore, të KLGJ dhe buxhetit të gjykatave, u evidentuan fondet e lira si më poshtë:

- Nga programi i buxhetit të KLGJ-së, KPSAB sugjeron fonde të lira, në shumën 11 milion lekë, për shkak të vendeve vakante akoma të paplotësuara në burime njerëzore.
- Nga programi i buxhetit të Gjykatave KPSAB sugjeron fonde të lira, në shumën 153 milion lekë, për shkak të mosrealizimit të fondit të programuar për ruatjen dhe sigurimin e shëndetit, për gjyqtarët e gjykatave të posaçme dhe mos likuidimit të faturës së kryerjes së shërbimit të sigurisë fizike në Gjykata, për muajin dhjetor.

Për sa u paraqit, KPSAB propozon miratimin e fondeve të lira, nga buxheti i vitit ushtrimor 2020, në sistemin gjyqësor, për këto vlera:

- në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, për shumën prej 11 milion lekë,
- në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i Gjykatave, për shumën prej 153 milion lekë.


69. Vendimi nr. 652, datë 29.12.2020 “Për detajimin e fondeve buxhetore, në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2021”, në kuadër të së cilit janë miratuar, në total, 3,444,200 mijë lekë, në tre programet buxhetore (Programi buxhetor 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, Programi buxhetor 03310 - “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet dhe Programi buxhetor 01140 - “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së teknologjisë së infirmacionit për sistemin e drejtësisë)

6. PËRMIRËSIMET NË INFRASTRUKTURËN TEKNOLOGJIKE NË FUNKSION TË RRITJES SË TRANSPARENCËS, EFICENCËS DHE AKSESIT NË SISTEMIN GJYQËSOR

Menjëherë me marrjen në administrim nga KLGJ të Sistemit të Menaxhimit Çështjeve, në zbatim të Urdhërit nr. 232, datë 4.11.2019 “Për ngritjen e Grupit të Punës, për kryerjen e një studimi, në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve në gjykata”, u përpilua një raport i detajuar mbi zhvillimet e mundshme që mund të realizoheshin duke patur parasysh pamundësitë teknike që kishte sistemi. Raporti i grupit të punës u përdor si bazë e përgatitjes së dokumentave standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike, për kontratën me objekt “Zhvillim, modifikim, përmirësim dhe mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve”

Eksperiencat e mëparshme të menaxhimit të sistemit nuk jepnin shumë optimizëm në përbushjen e kërkesave për zhvillime. Gjatë 6 viteve (2014-2019), nga kontratat e përvitshme të mirëmbajtjes nuk ishin arritur më shumë se 53 zhvillime në total, por dhe këto zhvillime jo të ndonjë rëndësie dhe impakti të qënësishëm në përmirësimin e punës në gjykata.

Për vitin 2020, KLGJ në bashkëpunim me kompaninë “KREATX” shpk, ka bërë të mundur instalimin e versionit të përmirësuar të sistemit të menaxhimit të çështjeve ICMIS, duke shtuar në këtë version 84 zhvillime të reja, disa nga të cilat shumë të rëndësishme për sistemin gjyqësor dhe punën në KLGJ.



Ndër zhvillimet më kryesore të realizuara po radhisim si më poshtë:

1. Përditësimi i sistemit (upgrade)

- Optimizimi i teknologjisë në një version më të ri
- I përshtatshëm në çdo lloj browser-i (IE explorer 12, Google Chrome, MS Edge)
- I përshtatshëm në sistemet operative të reja (Windows Server 2016, SQL Server 2016)

Versioni i mëparshëm i sistemit ICMIS ka funksionuar bazuar në teknologji softëare të vjetra, të cilat nuk janë të përshtatshme me sistemet operative të reja që përdoren sot nga sistemi

gjyqësor. Elementët e rinj të shtuar rishtazi janë shumë të rëndësishëm për mirëfunksionimin, shpejtësinë e veprime dhe sigurinë e sistemit ICMIS.

2. Anonimizimi automatik i të dhënave

- Në zbatim të detyrimeve ligjore që vijnë nga ligji Nr. 9887 dt.10/03/2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është mundësuar anonimizimi automatik i të dhënave sensitive.
- Anonimizimi është gjithashtu i vlefshëm dhe për vendimet e viteve të kaluara.

Më parë, anonimizimi i vendimeve gjyqësore kryhej në mënyrë manuale nga ana e punonjësve, gjë e cila përvec se kërkonte shumë kohë duke marrë parasysh ngarkesën, rriste edhe shkallën e gabimit njerëzor në këtë proces.

Benefitet e këtij zhvillimi lidhen drejtpërdrejt me uljen e investimeve si në fushën e burimeve njerëzore ashtu dhe në koston e blerjes së një softëare-i të jashtëm për automatizimin automatik. Gjithashtu, anonimizimi mundëson njohjen e publikut me vendimet gjyqësore duke rritur transparencën në vendimarrje si dhe respektimin dhe mbrojtjen e jetës private të individëve duke ruajtur të dhenat personale të tyre.

3. Saktësia e regjistrimit të të dhënave

Ndërveprimi i sistemit ICMIS me sistemet elektronike:

- Regjistri i Zyrës së Gjendjes Civile
- Regjistri i Qendrës Kombëtare të Biznesit

Të dhënat e regjistruara në sistem tashmë janë të sakta duke qenë se popullohen automatikisht me vendosjen e NID-it/NIP-it përkatës e cila mundëson identifikimin unik të çdo përdoruesi. Ky validim kryhet që në fazën e regjistrimit të çështjes dhe mundësohet nëpërmjet integritetit me sistemet e lart-përmendura.

4. Pasqyrimi i datës dhe orës në regjistrimin e veprimeve

- Regjistrimi i veprimeve RIV
- Shortimi i çështjeve
- Rishortimi i çështjeve

Në kuadër të transparencës dhe verifikimit të veprimeve, tashmë të gjithë raportet e gjeneruara në sistem pasqyrojnë datën dhe orën e saktë të kryerjes së veprimit.

5. Evidentimi i afateve të shqyrtimit të çështjes

Nëpërmjet një dritareje njoftuese në sistem do të shfaqen çështjet të cilave po u afrohen afateve ligjore. Ky njoftim do tu shfaqet:

- Kryetarëve të gjykatave (në mungesë i shfaqet Zv. Kryetarit)
- Kryesekretar-eve

- Gjyqtarëve
- Këshilltarëve

Njoftimi do të shfaqet 1 muaj para përfundimit të afatit ligjor.

Për të shmangur çështjet përtej afateve ligjore, në sistem është shtuar një rubrikë e re. Kjo rubrikë ka të bëjë me evidentimin në kohë të çështjeve, bazuar në afatin e përcaktuar në nenin 399/2 të K.Pr.Civile.

6. U përshpejtua procesi i printimit të dosjes elektronike me vetëm 1 click, për raportet:

- Fleta e regjistrimit të çështjes;
- Procesverbalet e seancave gjyqësore;
- Regjistrimi I veprimeve RIV;
- Vendimet e Gjykatës;
- Të dhënat e palëve etj,

Informacionet lidhur me çështjet gjyqësore më parë gjeneroheshin manualisht. Ky proces tashmë ka një kohëzgjatje shumë më të ulët dhe gjenerimi mundësohet me vetëm një klikim. Raportet e gjeneruara mund të përdoren për qëllime inspektimi, verifikimi dhe transferimi elektronik të çështjeve në gjykata të tjera.

7. Identifikimi i çështjeve të paraqitura më parë

Sinjalizimi i çështjeve të identifikuar si të paraqitura më parë me të njëjtin objekt/palë.

Në momentin e sinjalizimit, përdoruesit i jepet mundësia për të konfirmuar ose jo regjistrimin e çështjes në fjalë.

Ky zhvillim evidenton çështjet e ngjashme dhe kryen verifikime lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjes. Personi që po kryen regjistrimin sinjalizohet në kohë reale. Nëse çështja e mëparshme është pushuar bëhet kalimi tek gjyqtari që ka vendosur pushimin e çështjes, nëse është vendosur arsye tjetër, gjyqtarit i bëhet me dije vendimi përkatës për të shmangur vendimet paralele me të njëjtat palë/objekt.

8. Pasqyrimi në sistem i ndryshimeve ligjore KC & K.Pr.Civile

Funksionalitetet shtesë janë në bazë të ndryshimeve të Kodit Civil dhe K.Pr.Civile në sistemin ICMIS

- Unifikimi i listës për tipet e çështjeve;
- Unifikimi i listës për tipet e dispozitiveve;
- Shortimi i çështjeve duke përjashtuar Gjyqtarin për të cilin është kërkuar përjashtimi nga shqyrtimi i çështjes;

Këto ndryshime i shërbejnë përpos të tjerave gjenerimit të të dhënave statistikore dhe evidentimit të çështjeve sipas objektit.

9. Pasqyrimi në sistem i ndryshimeve ligjore KP & K.Pr.Penale

Funksionalitete shtesë janë në bazë të ndryshimeve të Kodit Penal dhe K.Pr.Penale në sistemin ICMIS

- Unifikimi i listës për tipet e çështjeve;
- Unifikimi i listës për tipet e dispozitiveve;
- Shortimi i çështjeve duke përjashtuar Gjyqtarin e hetimeve paraprake dhe Gjyqtarin e seancës paraprake

Këto ndryshime i shërbejnë përpos të tjerave gjenerimit të të dhënave statistikore dhe evidentimit të çështjeve sipas objektit/veprës penale.

10. Pasqyrimi i ndryshimeve të Kodit Penal për të Mitur

Funksionalitete shtesë janë në bazë të ndryshimeve të Kodit Penal dhe K.Pr.Penale në sistemin ICMIS

- Unifikimi i listës për tipet e çështjeve;
- Unifikimi i listës për tipet e dispozitiveve;
- Evidentimi i çështjeve me të mitur;

Këto ndryshime i shërbejnë përpos të tjerave gjenerimit të të dhënave statistikore.

11. Gjenerimi i raporteve të reja statistikore

Përmirësime në cilësinë dhe performancën e të dhënave të raporteve që gjenerohen nga sistemi ICMIS. **Janë shtuar raportet:**

1. Urdhër Mbrojtje;
2. Dhuna në Familje;
3. Krimi i Organizuar;
4. Çështje përtej afateve ligjore;

Tashmë mund të:

- Identifikohen në përqindje seancat që kanë hasur vonesa/seancat kanë nisur në kohë;
- Gjenerohen raporte për vlerësimin e gjyqtarëve në mënyrë të sakte, bazuar në analiza/verifikime të hollësishme;
- Filtrohen çështje në bazë të tipit dhe disponimit të gjykatës;

12. Ristrukturim i portalit të gjykatave

Në funksion të transparencës dhe orientimit të publikut, janë shtuar në menu-në kryesore informacionet që pasqyrojnë:

- Si të ngremë një kërkesë padi;
- Si të bëjmë një ankim në gjykatë;

- Tarifa Gjyqësore;
- Njoftime;
- Njoftime për median;
- Njoftime për publikun;
- Vende vakante;
- Njoftime të tjera;
- Mbledhjet e këshillit të gjykatës;

7. PLANIFIKIMI FINANCIAR NË FUNKSIONIN TË ADMINISTRIMIT TË MIRË DHE EFIKAS TË VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DHE GJYKATAVE

Gjatë vitit ushtrimor 2020, Komisioni i Zhvillimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, krahas detyrave dhe përgjegjësisve të tjera, në lidhje me buxhetin vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Sistemit Gjyqësor, ka ndjekur të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës.

Komisioni i Zhvillimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, shqyrton dhe i propozon për miratim KLGJ-së projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm të propozuar nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, për KLGJ-në dhe për çdo nivel të gjykatave dhe e kalon atë në seancën plenare për shqyrtim dhe miratim, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit përkatës.

Gjatë vitit ushtrimor, Komisioni i Zhvillimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit, kryen edhe monitorimin dhe rialokimin e fondeve të akorduara, bazuar në kërkesat e gjykatave për fonde shtesë që mund të lindin gjatë vitit ushtrimor.

Për vitin 2020, me ligjin nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2020, pjesë e të cilit është edhe buxheti për sistemin gjyqësor (Këshilli i Lartë Gjyqësor), i ndarë në dy programe;

- Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Programi buxhetor 03310, “**Buxheti Gjyqësor**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Fondet buxhetore të sistemit gjyqësor, të rishikuara, së bashku me realizimin 12 mujor, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme;

*Pasqyra nr.1,
Buxheti i miratuar për Sistemin Gjyqësor për vitin 2020*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti miratuar për vitin 2020	Ndryshime gjate vitit 2020	Buxheti rishikuar për vitin 2020	Realizimi per vitin 2020	Realizimi per vitin 2020
1.	Shpenzime paga	2,432,000	-441,500	1,990,500	1,986,843	100%
2.	Shpenzime sigurimi	272,000	-40,000	232,000	222,988	96%
3.	Shpenzime operative	497,150	-33,500	463,650	427,887	92%
4.	Investime	208,000	0	208,000	112,071	54%
	Totali	3,409,150	515,000	2,894,150	2,749,789	95%

Gjatë vitit buxhetor 2020, buxheti i sistemit gjyqësor për shkak të situatës është rishikuar 4 herë, duke u shkurtuar në vlerën totale prej **515,000 mijë lekë**, (nga të cilat në shpenzime paga në vlerën 441,500 mijë lekë, shpenzime sigurime shoqërore 40,000 mijë lekë dhe shpenzime operative në vlerën 33,500 lekë), si më poshtë:

- Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.15, datë 15.04.2020, në vlerën **109,000 mijë lekë** nga të cilat: **90,000 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor” dhe **19,000 mijë lekë** në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.
- Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.28, datë 02.07.2020, në vlerën **153,000 mijë lekë** nga të cilat: **140,000 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor” dhe **13,000 mijë lekë** në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.
- Pakësimi i buxhetit me VKM nr. 926, datë 25.11.2020, “Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e viti 2020 ndërmjet ministrive dhe institucioneve buxhetore”, në vlerën **150,000 mijë lekë** nga të cilat: **135,000 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor” dhe **15,000 mijë lekë** në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.
- Pakësimi i buxhetit me Aktin Normativ nr.34, datë 16.12.2020, në vlerën **103,000 mijë lekë** në programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”.

Buxheti i miratuar për vitin 2020, për sistemin gjyqësor, i ndarë sipas programeve paraqitet sipas pasqyrës së mëposhtme;

*Pasqyra nr.2
Buxheti i miratuar sipas programeve për vitin 2020*

000 lekë

Kodi	Emërtimi	Paga	Sig. shoqërore	Shpenzime operative	Shpenzime investime	Totali shpenzime buxhetore
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	188,000	27,000	60,150	49,600	324,750

03310	Buxheti Gjyqësor	2,244,000	245,000	437,000	158,400	3,084,400
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	2,432,000	272,000	497,150	208,000	3,409,150

I. Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fondet buxhetore të miratuara për programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, sipas emërimit të shpenzimeve, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme;

*Pasqyra nr.3
Buxheti i miratuar për programin 01110*

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2020	Ndryshime gjate vitit 2020	Buxheti i rishikuar per vitin 2020	Realizimi për 2020	Diferenca	Realizimi %
1	Shpenzime paga	188,000	-37,000	151,000	149,490	1,510	99%
2.	Shpenzime sigurime	27,000	-5,000	22,000	18,260	3,740	83%
3	Shpenzime operative	60,150	0	60,150	58,345	1,805	97%
4	Investime	49,600	0	49,600	33,728	15,872	68%
	Totali	324,750		282,750	259,823	22,927	92%

Fondet buxhetore në programin “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, janë realizuar në masën **92%**, ose në vlerë absolute në shumën **259,823 mijë lekë**.

I.1- Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore)

Buxheti i miratuar në shpenzime personeli është **215,000 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht **188,000 mijë lekë** në paga dhe **27,000 mijë lekë** në sigurime shoqërore. Ky fond është përlllogaritur dhe miratuar për **125 punonjës**. Buxheti i rishikuar është 173,000 mijë lekë.

Realizimi në shpenzime personeli është në masën 97%.

I.2 - Shpenzime operative

Në shpenzime operative është miratuar një fond në vlerën **60,150 mijë lekë**. Në këtë fond u përfshinë nevojat në shpenzimet operative për aktivitetin e përditshëm të KLGJ-së, referuar zërave të shpenzimeve si dhe të dhënave për vitin e parë të aktivitetit.

Realizimi i shpenzimeve operative është në masën 97%,

Realizimi i shpenzimeve korrente tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet të tyre.

KLGJ-ja, krahas administrimit dhe menaxhimit të fondeve të programit të KLGJ-së, ka administruar dhe menaxhuar edhe një pjesë të fondit të programit buxhetor të gjykatave në

shpenzime operative, në vlerën prej 68,950 mijë lekë, e cila është prokuruar dhe realizuar në vlerën 64,200 mijë lekë ose në masën 93%. Disa nga zërat kryesore të këtyre shpenzimeve janë:

- Shërbimi i rojeve dhe sigurisë fizike të gjykatave, prokuruar në vlerën **45,300 mijë lekë**, bazuar në VKM nr. 177, datë 04.04.2019 “Për krijimin e shoqërisë Ilyrian Guard sh.a dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie” dhe Udhëzimin e përbashkët midis MFE dhe MB. Ky shërbim është realizuar në vlerën 41,800 mijë lekë, ose 92%.
- Përmirësimi dhe zhvillimi i programit të menaxhimit të çështjeve (ICIMIS), programuar në vlerën 25,000,000 lekë, fondi limit i përlogaritur, në vlerën prej 24,818 mijë lekë, dhe është realizuar në vlerën 22,078 mijë lekë ose në masën 89 %.

I.3 - Shpenzime Kapitale

Buxheti i miratuar në shpenzime kapitale (investime) ishte **49,600 mijë lekë**. Në këtë fond kanë qënë përfshirë kryesisht nevojat për pajisje teknologjike. Realizimi i shpenzimeve kapitale është në **masën 68 %**.

Masa e realizimit në terma sasimore apo vlerë absolute të produkteve është e lidhur me:

- tepricat e fondeve si rezultat i diferencave të krijuara nga blerjet me prokurime online dhe vlerës së fondit limit. Pothuaj në të gjitha produktet vihet re një ulje e kostos për njësi në fund të vitit raportues, krahasuar me atë në fillim të vitit e cila reflektohet si tepricë e fondeve.
- Vendosjen në ambientet e godinës Poli i Drejtësisë. Kjo godinë, e administruar nga Ndërmarrja Industriale nr. 1, ishte e plotësuar me pajisje të zyre dhe disa pajisje IT. Kjo bëri që një pjesë e fondeve të planifikuara për këtë qëllim, u përdorën për plotësimin e nevojave të tjera në funksion të aktivitetit të KLGJ-së.

Kështu, Sistemi audio-video dhe përkthimi simultan në sallën e mbledhje, është realizuar me një kursim prej 244 240 lekë, **ose 3 % më pak se vlera e programuar**.

Gjeneratori dhe UPS i përgjithshëm, është realizuar me një kursim prej 2,260,000 lekë, **ose 23 % më pak se vlera e programuar**.

Pajisja e sistemit të qarkullimit të dokumentave, është realizuar me një kursim prej 842,800 lekë, **ose 9 % më pak se vlera e programuar**.

Pajisjet Kompjuterike dhe Laptop, është realizuar me një kursim prej 329,400 lekë, **ose 9 % më pak se vlera e programuar**.

Blerja e sistemeve të sigurimit, është realizuar me një kursim prej 242,400 lekë, **ose 34 % më pak se vlera e programuar**.

II-Programi buxhetor 03310, “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Pasqyra nr.4
Buxheti i miratuar për programin 03310

000 lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti i miratuar në fillim të vitit 2020	Ndryshimet gjatë vitit 2020	Buxheti rishikuar 2020	Realizimi	Diferenca	Realizimi %
1	Shpenzime paga	2,244,000	404,500	1,839,500	1,837,353	2,147	100%
2.	Shpenzime sigurime	245,000	35,000	210,000	204,728	5,272	97%
3	Shpenzime operative	437,000	33,500	403,500	369,542	33,958	92%
4	Investime	158,400	0	158,400	78,343	75,335	49%
	Totali	3,084,400	473,000	2,611,400	2,489,966	116,712	95%

Fondet buxhetore në programin “Buxheti Gjyqësor”, janë realizuar në masën **95 %**.

II.1- Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore).

Buxheti i miratuar në këto shpenzime është **2,489,000 mijë lekë**, i ndarë në **2,244,000 mijë lekë** në paga dhe **245,000 mijë lekë** në sigurime shoqërore.

Buxheti në shpenzime personeli në këtë program është përlllogaritur mbështetur në numrin e plotë të punonjësve sipas strukturave organike për të gjitha gjykatat dhe pagave, sipas akteve ligjore në fuqi si për magjistratët ashtu edhe për administratën gjyqësore.

Realizimi në shpenzime personeli është në masën 100 %. Numri faktik i punonjësve në gjykatat e të gjitha niveleve, në fund të vitit 2020, është **1,284** punonjës, kundrejt **1,548** punonjës sipas strukturës organizative, pra 254 punonjës më pak, nga të cilët; 69 janë magjistratë, mungesa të cilat janë për shkak se janë të shkarkuar nga KPA-ja me vendim të formës së prerë, janë të dorëhequr, ose janë vende vakante të paplotësuara më parë, 115 administratë gjyqësore. Këto mungesa ka qënë e pamundur të plotësoheshin të gjitha brenda vitit 2020.

Në kuadër të të mirëmenaxhimit të fondeve buxhetore, Ministria e Financave dhe Ekonomise, në kuadër dhe të nevojës që ka patur për rialokime fondesh për shkak të Covid – 19, ka miratuar disa akte normative (të sipërcituara), me anë të të cilave ka pakësuar këto fonde.

II.2 - Shpenzime operative

Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2020 është **437,000 mijë lekë**.

Shpenzimet operative përbëjnë ato shpenzime që kanë të bëjnë me aktivitetin e përditshëm të gjykatave. Këtu përfshihen shpenzime kancelarie, shpenzime energjie elektrike, shpenzime uji, shpenzime mirembajtje godine, pajisje elektronike, shpenzime poste, shpenzime për

eksperte, avokatë kryesisht, etj. Gjithashtu përfshihen edhe shpenzime të tjera specifike të cilat të kryhen nga gjykata jo çdo vit por sipas rrethanave të krijuara. Të tilla janë shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, shpenzime për kolegjin zgjedhor, etj

Realizimi në shpenzime operative është në masën 92%.

Pavarësisht vështirësive që solli viti 2020 për shkak të pandemisë globale COVID-19, gjykatat kanë bërë përpjekje maksimale për të mirëmenaxhuar fondet buxhetore në mënyrë efektive dhe eficiente.

II.3 -Shpenzime kapitale për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Buxheti i miratuar për këtë program është **158,400 mijë lekë**. Këto fonde janë ndarë sipas projekteve të mëposhtme;

000 lekë

Kodi i projektit	Emertimi i projektit	Fondet buxhetore 2020	Rishikim buxheti	Realizimi vjetor 2021	Diferenca	Realizimi %
18AD801	Blerje pajisje zyre	18,740	20,840	17,755	2,980	86%
M290072	Blerje pajisje elektronike	33,800	33,800	20,126	13,937	59%
M290066	Studime dhe Projektme	10,740	10,440	119	10,321	1%
M290068	Rikonstruksione	95,120	93,320	40,343	54,391	42%
	Totali	158,400	158,400	78,343	81,629	49%

Realizimi në shpenzime kapitale për programin 03310 është në masën 49 %, për arsyet e mëposhtme :

- Realizimi në masën 86% të vlerës së detajuar në blerjen e pajisjeve të zyrës, ka ardhur si rezultat i kursimit kundrejt fondit limit përllëguar nga procedurat e prokurimit online.
- Në realizimin në masën 59% të vlerës së akorduar për pajisje elektronike ka ardhur kryesisht nga kursimit kundrejt fondit limit nga procedurat e prokurimit online, në vlerën **8,337 mijë lekë**, pjesa tjetër nga mosrealizimi i procedurave të prokurimit në 4 gjykata.
- Në artikullin “Studime dhe projektme” fondi i detajuar për Gjykatën e Rrethit gjyqësor Durrës, në masën 10,000 mijë lekë, nuk u realizua. Kjo gjykatë ka qenë e përfshirë në planin strategjik të zhvillimit dhe prej disa vitesh është evidentuar nevoja për ndërtimin një godine të re pasi ekzistuesja nuk plotëson kushtet infrastrukturore për zhvillimin e proceseve gjyqësore solemne e transparente. Gjithashtu kjo e fundit nuk plotëson as kushtet e punës për gjyqtarët dhe stafin administrativ për të ofruar shërbime të shpejta transparente e cilësor ndaj publikut. Në kushtet kur në planin strategjik të KLGJ-së ishte përcaktuar hartimi i projektit për godinën e re dhe gjithashtu parashikohej se do të ishte përfunduar Harta e Re Gjyqësore, u akorduan këto fonde. Duke qenë se harta e re gjyqësore nuk është dakordësuar ende, gjatë vitit ushtrimor, Këshilli vendosi që ky projekt të mos realizohet.

- Në zërin “Rikonstruksione” vërehet një realizim në masën 42%. Këtu është akorduar fondi 8,500 mijë lekë për riparimin e dëmeve nga tërmeti dhe është realizuar në masën 100% nga 6 gjykatat e prekura.

Fondi prej 44,500 mijë lekë u akordua për 12 gjykata për kryerjen e rikonstruksioneve të pjesshme të vogla në nivel mirëmbajtje nga të cilat janë realizuar në masën 32,000 mijë lekë ose 72%. Diferenca në realizim vjen për shkak të mirëmenxhimit të procesit të prokurimit online i cili është realizuar me një vlerë më të vogël se ajo e parashikuar. Pjesa tjetër prej 40,000 mijë lekë u mbajt e padetajuar në shërbim të zhvillimeve eventuale të lidhura me zhvillimin e sistemit të ri elektronik të menaxhimit të çështjeve në gjykata.

Gjatë vitit 2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë u kërkua ndërtimi i regjistrit elektronik të OJF-ve dhe kjo si pjesë e planit të veprimit për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave. Mbledhja plenare e KLGJ-së nuk konkludoi me miratimin e fondit të propozuar nga kjo gjykatë, e për pasojë pezullimin e këtij projekti.

Për sa më sipër, siç shikohet edhe nga analiza raportuese, realizimi i buxhetit për vitin 2020, në sistemin gjyqësor, rezulton në masën 95 %, nga të cilat;

- në shpenzime paga, në masën 100 %,
- në shpenzime sigurime shoqërore, në masën 96 %,
- në shpenzime operative, në masën 92 %
- në shpenzime kapitale, në masën 54 %.

Si përfundim, KPSAB ka dëshmuar një performancë të lartë duke reaguar ndaj nevojave në sistemin gjyqësor në mënyrë të shpejt dhe të drejtë, gjë e cila ka mundësuar një vendimmarrje të drejtë dhe ligjore në funksion të menaxhimit të fondeve buxhetore me efikasitet dhe efektivitet.